



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.324/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Climasan” SH.P.K., me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson shoqëria e avokatëve “Legus” SH.P.K., me seli në Prishtinë, kundër debitorit A.D. B.I., me seli në Gjakovë, Rr.“Skënderbeu”, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson shoqëria e avokatëve “Vokshi & Lata”, me seli në Prishtinë, me bazë juridike përmbarimore, pagesë e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e autorizuarit të debitorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2054/2022 të datës 20.09.2023, me datë 07.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e debitorit A.D. B.I., me seli në Gjakovë, Rr.“Skënderbeu”, ANULOHET aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2054/2022 i datës 20.09.2023 dhe Lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2054/2022 të datës 20.09.2023, ka hedhur poshtë si të pa afatshëm prapësimin e debitorit A.D. B.I., me numër unik identifikues 811144328, me seli në Gjakovë, të ushtruar ndaj urdhrit përmbarimor P.nr.5/2022, të lejuar me datë 12.01.2022, nga Përmbaruesi Privat Mubarak Shumolli.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i debitorit për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përmbarimore dhe kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet në tërësi ankesa e debitorit dhe të anulohet aktvendimi i ankimuar ashtu që çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e debitorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Climasan” SH.P.K., me seli në Prishtinë, me datë 12.01.2022, ka paraqitur propozim për përmbaram kundër debitorit A.D. B.I., me seli në Gjakovë, Rr.“Skënderbeu”, në bazë të dokumentit të besueshëm - faturës nr.21-SHV01-C68-3 të datës 12.11.2021, faturës nr.21-SHV01-C68-4 të datës 12.11.202, faturës nr. 21-SHV01-C68-2 të datës 13.09.2021 si dhe faturës nr.19-SHV01-C68-1 të datës 30.07.2021, për shumën e përgjithshme të detyrimit prej 20,789.38 Euro.

Përmbaruesi privat Mubarak Shumolli, duke vepruar sipas propozimit për përmbaram të kreditorit, me urdhrin P.nr.5/2022 të datës 12.01.2022, ka lejuar përmbaramin kundër debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm – faturave, duke vlerësuar se dokumenti i besueshëm i plotëson kushtet për përmbaram. Kundër këtij urdhri përmbaramor debitori ka paraqitur prapësim, duke e kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbaramor, me arsyetimin se faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri janë lëshuar për punë të cilat nuk janë përfunduar në tërësi nga ana e kreditorit, i cili fakt nuk është kontestues as nga ana e kreditorit. Më tej, ka shtuar se kreditori ka refuzuar që të bëjë vlerësimin e punëve të përfunduara dhe ka iniciuar procedurë përmbaramore për përmbushjen e pagesës për punë për të cilat nuk është bërë pranimi në mënyrë të rregullt. Andaj ka propozuar, që prapësimi të aprovohet si i bazuar ndërsa urdhri përmbaramor të anulohet.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori me datë 01.02.2022, duke theksuar se urdhri është lejuar në përputhje me dispozitat nga neni 22, 27, 29 dhe 38 të LPP-së. Ndërsa, në raport me pretendimet e debitorit, ka theksuar se asnjë faturë nuk është lëshuar për punë të papërfunduara, dhe se të gjitha faturat kanë të bëjnë vetëm për punët të cilat kreditori i ka kryer për nevojat dhe sipas kërkesës së debitorit. Më tej, ka theksuar se të gjitha faturat janë lëshuar nga kreditori dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori, i cili nuk i ka kundërshtuar brenda afateve të përcaktuara me dispozitat ligjore, mirëpo të njëjtat i ka kundërshtuar vetëm me datën 30.12.2021 përmes e-mail, andaj ka propozuar që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar, kurse urdhri përmbaramor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2054/2022 të datës 20.09.2023, me të cilin ka Hedhur poshtë si të pa afatshëm prapësimin e debitorit A.D. B.I., me numër unik identifikues 811144328, me seli në Gjakovë, të ushtruar ndaj urdhrin përmbaramor P.nr.5/2022, të lejuar me datë 12.01.2022, nga Përmbaruesi Privat Mubarak Shumolli, me arsyetimin se prapësimi nuk është paraqitur brenda afatit të paraparë me dispozitat ligjore të LPP-së, konkretisht nënin 70 të LPP-së. Debitori urdhrin përmbaramor e ka pranuar me datë 17.01.2022, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar të rrjedhe nga data 13.01.2023, e si ditë e fundit për paraqitjen e prapësimit ka qenë data 24.01.2022. Debitori me datë 25.01.2022 ka paraqitur prapësimin dhe nuk ka prova që prapësimi është dorëzuar në ndonjërin nga mënyrat tjera të përcaktuara për dërgimin e shkresave, qka rezulton se debitori prapësimin e ka paraqitur pas kalimit të afatit ligjor.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë, rreth mënyrës së vendosjes, nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i ankimuar është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 1 të LPK-së, e lidhur me nenin 70 LPP-së.

Aktvendimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje nga neni 70 i LPP-së, për arsye se gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit të prapësimit gabimisht ka vlerësuar afatin e paraqitjes së prapësimit duke e vlerësuar se i njëjti ka filluar të rrjedh nga 13.01.2023, e nga shqyrtimi i shkresave të lëndës nga kjo gjykatë vërtetohet se debitori propozimin - urdhrin për lejimin e përmbartimit P.nr.5/2022 të datës 12.01.2022, të Përmbartuesit Privat Mubarak Shumolli, e ka pranuar me datë 17.01.2022, ndërsa prapësimin tek Përmbartuesi Privat e ka dorëzuar nëpërmes postës me datë 24.01.2022, i cili konsiderohet si dorëzim i rregullt i prapësimit në kuptim të dispozitës së neni 127 paragrafi 2 të LPK-së, dhe i njëjti është ushtruar brenda afati ligjor 7 ditor, siç përcaktohet me nenin 70 të LPP-së, ku theksohet se: *“Prapësimi duhet t’i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve, pas pranimit të vendimit përmbartues ose urdhrit përmbartues”*.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, nga interpretimi i dispozitës se lartcekur rezulton se gjykata e shkallës së parë ka vepruar në mënyrë të gabuar kur ka vendosur që prapësimi i debitorit të hedhet si i pasafatshëm, për çka aktvendimi i ankimuar është dashtë të anulohet.

Në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë udhëzohet që duke pasur parasysh shkeljet e konstatuara si më lartë nga gjykata e shkallës së dytë, të vlerësoj dhe vendos në mënyrë meritore lidhur me prapësimin e ushtruar nga pala debitore të cilin ligjërisht duhet ta trajtoj si të afatshme, ku përmes vlerësimit të drejtë dhe në mënyrë objektive të të gjitha shkaqeve sipas prapësimit të ushtruar nga pala debitore, por gjithnjë duke vlerësuar edhe shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës, për të cilat gjykata çdoherë kujdeset sipas detyrës zyrtare edhe pa prapësimin e palëve në procedurë, të ketë mundësi që të bie një vendim të drejtë i cili do të ketë mbështetje në provat prezent në shkresat e lëndës dhe në ligj, duke pasur parasysh gjithashtu që me rastin e vendosjes, pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitohet shkeljet procedurale të konstatuara si më lartë nga gjykata ankimore, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me dispozitën e neni 160 të LPK-së.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1, pika d) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE e KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.Dh.SH.II.nr.324/2024, me datë 07.05.2024.

Gjyqtari,
Krenar Berisha